

Korrik 2013, Prizren

KOMUNIKATË Formohet Komisioni për festat e qershorit

Në kuadër të projektit “Rritja e pjesëmarrja përmes medieve sociale”, EC Ma Ndryshe ka nisur monitorimin e vendimeve të qeverisë komunale në sektorin e rinisë. Për muajin qershor të këtij viti, janë marrë disa konkluzione nga kryetari i komunës për realizimin e projekteve rinore, kulturore dhe sportive.

Nga kryetari i Komunës janë miratuar propozimet e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për formimin e Komisionit teknik për organizimin dhe shënimin e manifestimeve të Qershorit dhe mbështetjen financiare të dy organizimeve.

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 4 qershor 2013 me drejtoritë komunale miratoi propozimin për formimin e Komisionit 5 anëtarësh për shënimin e manifestimeve të Qershorit, që do të kryesohet nga Koordinatori për Rini, Kujtim Gashi. Detyrat e Komisionit teknik do të jenë: të përgatit projektin për organizimin e të gjitha aktiviteteve dhe pas përfundimit të të gjitha organizimeve, të mbledh dhe verifikoj të gjitha shpenzimet e bëra dhe të njëjtat t'i procedoj për pagesë, si dhe mund të marrë veprime të tjera të nevojshme, të cilat janë në korniza të këtij manifestimi.

Gjithashtu në këtë mbledhje u miratua propozimin e DKRS-së për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për manifestimin kulturor tradicional të komunitetit turk “Zgjimi me Art 2013”, me vlerën prej 2000 euro.

Ndërsa në mbledhjen e datës 18 qershor 2013 për shënimin e “26 Qershorit – Dita Ndërkombëtare Kundër Substancave Narkotike”, kryetari i Komunës, lejoi ndarjen e 1,700 eurove.

Ky projekt është i paraparë në Komponentën IV të Politikave Rinore dhe do të organizohet në bashkëveprim me PMSH, Këshillin e Veprimit Rinor Lokal, Këshillin e nxënësve, etj.

Me respekt,
Elmedina Baxhaku, asistente e projektit
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

Projekti “Rritja e Pjesëmarrjes përmes Mediave Sociale”, përkrahjet financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Projekti SMILE i financuar nga Democratic Governance Thematic Trust Fund (DGTTF).



Empowered lives.
Resilient nations.